



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Komisioni i Pavarur për Media

Raporti vjetor i punës
për vitin 2010

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

shkurt 2011

Telefoni: 038 245 031

Telefaksi: 038 245 034

Ueb faqja: www.kpm-ks.org

E-mail: info@kpm-ks.org

PËRMBAJTJA:

| | |
|---------------------------|---|
| Parathënie..... | 4 |
| Baza ligjore..... | 6 |
| Struktura e raportit..... | 6 |

Pjesa I

| | |
|--|----|
| Objektivat për vitin 2010 dhe realizimi i tyre..... | 7 |
| 1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës..... | 7 |
| 2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës..... | 8 |
| 2.1 Lëshimi i licencave të reja..... | 8 |
| 2.2 Përbushja e obligimit kushtetues për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe..... | 9 |
| 2.3 Licencimi i operatorëve kabllor në veriun e Kosovës..... | 10 |
| 3. Promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese | 10 |
| 3.1 Zbatimi i Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale..... | 10 |
| 4. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht..... | 10 |
| 4.1 Rishikimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar..... | 10 |
| 4.2 Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale..... | 11 |
| 4.3 Rregullorja për nivelin dhe mënyrën e pagesës së licencës për shërbimet mediale audio-vizuale..... | 11 |
| 4.4 Rregullorja për operimet në sistemin kabllor..... | 12 |
| 5. Ngritja e kapaciteteve për monitorim të programeve..... | 13 |

Pjesa II

| | |
|--|----|
| Objektivat e KPM-së për vitin 2011..... | 13 |
| 1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës Rishikimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar..... | 14 |
| 2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës | 14 |
| 2.1 Lëshimi i licencave të reja në rrjetin analog..... | 14 |
| 2.2 Licencimi i operatorëve kabllor në veriun e Kosovës..... | 14 |
| 3. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht..... | 14 |
| 3.1 Rregullorja për operator kabllor..... | 14 |
| 3.2 Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore.. | 15 |

Pjesa III

| | |
|--|----|
| Prezantim i punës së Këshillit të KPM-së | 15 |
| Takimet dhe vendimet e Këshillit të KPM-së gjatë vitit 2010..... | 15 |
| Rregulloret e miratuara nga Këshilli i KPM-së..... | 16 |
| Organizimi i takimeve publike..... | 16 |
| Bashkëpunimi me institucionet vendore..... | 17 |
| Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare..... | 17 |

Pjesa IV

| | |
|---|----|
| Prezantim i punës së Zyrës së Shefit Ekzekutiv..... | 18 |
| Departamenti i Monitorimit dhe Analizave..... | 18 |
| Departamenti i Licencimit..... | 22 |
| Departamenti Ligjor..... | 24 |

| | |
|---|----|
| Departamenti i Menaxhimit Frekuencor..... | 27 |
| Departamenti i Administratës..... | 29 |

Pjesa V

| | |
|--|----|
| Prezantim i punës së Bordit për Ankesa të Mediave..... | 30 |
| Sqarime për shkurtesat e përdorura..... | 33 |

Shtojcat

1. Raporti financiar për vitin 2010
2. Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale
3. Rregullorja për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-vizuale
4. Monitorimi i medias elektronike gjatë fushatës për zgjedhje parlamentare 2010
5. Tabela e rasteve ligjore
6. Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të KPM-së dhe ART-së
7. Raporti lidhur me pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me Pjesën 3 të Licencës

PARATHËNIE

Në përmbyllje të vitit të punës, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) përmbushë obligimin ligjor për t'i paraqitur Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin e Punës për vitin 2010.

Gjatë vitit 2010, KPM ka bashkëpunuar me Kuvendin dhe organizmat tjerë relevante në ndryshimin e ligjit bazik për KPM-në dhe atë të RTK-së. Kontributi i KPM-së ka qenë i fokusuar në plotësimin dhe ndryshimin e këtyre dy ligjeve, duke ofruar komente të bazuara në direktivat dhe praktikatat më të mira evropiane. Ky harmonizimin paraqitet si domosdoshmëri dhe parakusht drejt procesit të integrimi në BE.

Ndryshimi i këtyre dy ligjeve u iniciua dy vite më parë nga përbërja e kaluar e Kuvendit. KPM në vazhdimësi ka ofruar komentet e veta të argumentuara në mënyrë që, përmes ndryshimit të Ligjit të KPM-së, të sigurohet fuqizimi i mëtutjeshëm i KPM-së në zbatimin e politikave mediale, konform standardeve ndërkombëtare, por gjithnjë duke mos cenuar pavarësinë institucionale të paraparë me Kushtetutë.

Leximi i parë i Ligjit për KPM-në është bërë pa u marrë në konsideratë komentet e ofruara nga KPM-ja. Draft-ligji për KPM-në nuk është në harmoni me praktikatat ndërkombëtare, prandaj si i tillë mbetet brengosës për KPM-në. Shqetësime lidhur me këtë kanë shprehur edhe Komisioni Evropian, OSBE dhe disa deputetë, anëtarë të komisioneve funksionale parlamentare, përmes së cilave ka kaluar leximi i parë i draft-ligjit të KPM-së.

Gjatë vitit 2010 është bërë një punë e frytshme në aspektin e plotësimit të bazës ligjore sekondare për veprimtarinë e KPM-së. Në përmbushje të objektivave të përcaktuara për këtë vit përkritazi me plotësimin e bazës ligjore sekondare, KPM hartoi dhe miratoi në formë të re dhe më të plotësuar:

- Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale; dhe
- Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës për Licencë për Shërbimet Mediale Audio-vizuale.

Pas periudhës për komente publike, përfshirë të gjithë akterët dhe palët me interes që ndërlidhen me platformën kabllore, KPM ka përgatit draftin e rregullores së re, të ndryshuar për ofrimin e përmbajtjeve programore përmes rrjetit kabllor. Në mungesë të kuorumit për të marr vendime, miratimi dhe fuqizimi i saj pritet të bëhet me emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit të KPM-së.

Këshilli i KPM-së, në bashkëpunim me komunitetin medial dhe institucionet relevante shtetërore, filloi punën në projektin me rëndësi nacionale – strategjinë për kalim në digjitalizim. Gjatë vitit 2009 KPM analizoi planin frekuencor digjital televiziv tokësor që rezultoi nga Konferenca e ITU-së RRC-06 dhe mblodhi në Prishtinë në një tubim ndërkombëtar rregullatorët rajonal për të shkëmbyer përvojat dhe për të ndihmuar në procesin përgatitor të Kosovës për të ecur drejt procesit të digjitalizimit. Në vitin 2010, KPM filloi punën konkrete përmes aktiviteteve të pesë grupeve të punës të krijuara për këtë qëllim. Këto grupe janë krijuar për të vendosur kornizën ligjore, teknike, programore dhe ekonomiko shoqërore të kalimit në transmetime numerike, kurse grupi i pestë është caktuar që të bëjë informimin por edhe edukimin e publikut për të qenë të gatshëm të pranojnë dhe të jenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm shtetëror.

Grupet punuese kanë arritur të përfundojnë vendosjen e kritereve bazike për formimin e kornizës së përgjithshme, e cila do të ndihmojë në përcaktimin e politikës së përshtatshme të shtetit tonë për procesin e kalimit në transmetimet numerike (digjitale). Me angazhimin e grupeve punuese, KPM ka arritur të hartojë draftin e parë të Strategjisë për kalimin nga transmetimi analog në transmetimin

digjital të Republikës së Kosovës. Shtetet anëtare të BE-së obligohen ta përmbyllin digjitalizimin në fund të vitit 2012, kurse për shtetet jo-anëtare, siç është Kosova, afati i fundit për përmbylljen e procesit të digjitalizimit është viti 2015.

Ka shumë punë për t'u bërë, dhe për t'u arritur ky qëllim nevojitet vazhdueshmëria e angazhimit dhe bashkëpunimit gjatë tërë procesit të hartimit të strategjisë të të gjithë akterëve me interes, përfshirë këtu komunitetin medial, por edhe institucionet relevante shtetërore siç është Kuvendi dhe Qeveria. Sidoqoftë, me interes të veçantë dhe të domosdoshëm për këtë proces është anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU). Për të arritur këtë synim, veprimet duhet të ndërmerren nga instancat më të larta shtetërore të Kosovës.

KPM është fokusuar gjithashtu edhe në monitorimin dhe vlerësimin e performancës së të licencuarve për të siguruar që operimet e tyre janë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së dhe rregulloret e nxjerra nga KPM. Gjatë vitit 2010 është realizuar një projekt i rëndësishëm, i bashkfinancuar nga Komisioni Evropian përmes programit IPA 2009. Ky projekt ka mundësuar që të pranohet sinjali i shumicës së subjekteve të licencuara transmetuese në Zyrën e KPM-së, dhe në këtë mënyrë është mundësuar të bëhet monitorimi i plotë i programeve të transmetuara.

Duhet të theksohet se KPM ka pasur një angazhim të shtuar gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme - për monitorimin e mediave për të siguruar që po respektohen parimet ligjore për mbulueshmërinë e fushatës nga ana e tyre, parime këto që janë përcaktuar me Ligjin mbi Zgjedhjet. KPM ka arritur që për këto zgjedhje të dalë me dy raporte në të cilat ka reflektuar të gjeturat nga monitorimet e bëra për TV stacionet dhe ofruesit e shërbimeve programore.

Këshilli i KPM-së në periudhën mars-qershor të vitit 2010 nuk ka funksionuar në përbërje të plotë, ngase procedura e emërimeve të anëtarëve nga Kuvendi nuk ka përfunduar me kohë. Kuvendi gjithashtu që nga viti 2008 nuk ka arritur të emërojë anëtarin e Këshillit që përfaqëson Kuvendin. Kjo parashihet me nenin 4, paragrafi 4.3 i Ligjit të KPM-së. Nga shtatë anëtarë të paraparë të Këshillit, aktualisht vetëm dy prej tyre janë me mandat. Katër anëtarëve të Këshillit që përfaqësojnë shoqërinë civile iu ka skaduar mandati me 15 dhjetor 2010. Në këtë mënyrë Këshilli i KPM-së në mungesë të kuorumit nuk mund të marrë asnjë vendim deri në emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit.

Komisioni i Pavarur për Media konsideron se ka realizuar me përgjegjësi, profesionalizëm, dhe transparencë një pjesë të madhe të objektivave të saj, të përcaktuara në vitin 2010. Megjithatë, për shkak të rrethanave politike të krijuara në vitin 2010, për pjesën tjetër të përmbushjes së objektivave të vitit 2010 KPM do të vazhdoj realizimin dhe përfundimin e tyre në vitin e ardhshëm. Inkurajon fakti që puna e KPM-së është theksuar pozitivisht edhe në raportin e progresit të BE-së për Kosovën për vitin 2010.

KPM, do të vazhdojë të punojë me përkushtim në projektet ambicioze të vitit 2011, duke u përpjekur që në këto projekte, të angazhojë sa më shumë ekspertë dhe profesionistë nga fusha e medias, por gjithëherë duke u konsultuar edhe me publikun, palët me interes dhe faktorët tjerë relevant, të cilët do të kontribuojnë në procesin e zhvillimit të një sektori të mirëfilltë medial.

Me këto synime, kemi kënaqësinë që Kuvendit të Republikës së Kosovës, t'i paraqesim Raportin vjetor të punës së KPM-së për vitin 2010.

Shkurt 2011
Këshilli i KPM-së, Prishtinë

BAZA LIGJORE

Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005.

Komisioni i Pavarur për Media është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 3.8. të Ligjit për KPM-në, Këshilli i KPM-së përgatit dhe i paraqet Kuvendit të Kosovës, brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, një raport vjetor duke përfshirë të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave, ankesave, sanksioneve që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit dhe objektivat e projektimit për vitin e ardhshëm.

Ligji i ri i KPM-së është në proces të draftimit dhe gjatë vitit 2010 është bërë leximi i tij i parë në Kuvendin e Kosovës.

STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti i punës për vitin 2010 i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media fillon me pasqyrimin e realizimit të objektivave të vitit 2010 dhe me pasqyrim të objektivave të përcaktuara për vitin 2011. Më pastaj bëhet në mënyrë të përmblodhur prezantim i punës së Komisionit të Pavarur për Media përmes punës së Këshillit të KPM-së, Zyrës së Shefit Ekzekutiv dhe Bordit për Ankesa të Mediave (BAM).

PJESA I

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2010 DHE REALIZIMI I TYRE

Për vitin 2010, Këshilli i KPM-së përcaktoi 5 objektiva:

1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës

Gjatë vitit 2010 KPM ka filluar punën në hartimin e draft- strategjisë për kalimin nga transmetimi analog në atë digjital. Puna është zhvilluar përmes grupeve punuese të cilat kanë pasur për obligim të vendosin kornizat bazike ligjore, teknike, programore dhe ekonomiko shoqërore për kalimin në transmetime digjitale(numerike). Njëri nga grupet është angazhuar në informimin dhe edukimin e publikut për të qenë të gatshëm të pranojnë dhe të jenë pjesë e këtij procesit rëndësishëm kombëtar. Gjatë tërë këtij procesi KPM ka bashkëpunuar me të gjithë akterët me interes përfshirë këtu komunitetin medial por edhe institucionet relevante shtetërore. Pesë (5) grupet punuese, të cilat janë angazhuar në hartimin e draft-strategjisë për digjitalizim janë:

Grupi për çështjet ligjore – Gjatë takimeve të këtij grupi punues janë hartuar dhe diskutuar amandamentet për Ligjin mbi Radio-Televizionin e Republikës së Kosovës si dhe mbi Ligjin mbi Komisionin e Pavarur për Media. Në njërin nga takimet e këtij grupi, është angazhuar një ekspert ndërkombëtar nga Rregullatori Italian AGCOM, i cili ka ofruar përvojat nga shteti i tij si dhe nga shtetet e BE-së, gjatë procesit të digjitalizimit.

Grupi punues është marrë me analizimin dhe studimin e akteve finale të Marrëveshjes së Gjenevës 2006, me fokus në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje. Grupi punues ka bërë rishikimin e akteve juridike të Kosovës që rregullojnë fushën audio-vizuale me qëllim të plotësimit të tyre për realizimin e suksesshëm të kalimit nga transmetimi analog në atë digjital në pajtim me standardet ndërkombëtare evropiane.

Grupi për çështjet programore – Puna në këtë grup punues është bazuar mbi tri strategji: atë të Mbretërisë së Bashkuar për shkak të logjikës konstitucionale, Gjermanisë për rolin e saj në promovimin e Unionit Evropian si dhe Italisë për shkak të botës së spektaklit për të cilën ajo njihet. Po ashtu janë konsultuar edhe strategjitë e shteteve rajonale, ku janë përfshirë Kuotat e Direktivës së AVMS-së lidhur me produksionet e pavarura si dhe prodhimet evropiane që janë specifikuar në pjesën programore. Këto kuota janë të detyrueshme vetëm për televizionin publik, ndërsa për televizionet private, ndonëse të preferueshme, nuk kanë karakter detyrues.

Gjithashtu ky grup punues përbrenda dokumentit të draft-strategjisë, tek Pjesa programore, është bazuar në Direktivën e Unionit Evropian mbi Shërbimet Mediatike, Audio-Vizuale (AVMS) dhe ka për qëllim që të ngrisë kapacitetet profesionale dhe për më tepër të ngrisë cilësinë programore të shërbimeve mediale audio-vizuale.

Pjesa e draft strategjisë për Çështje Programore është finalizuar dhe e mbështetur nga të gjithë anëtarët e grupit punues.

Grupi për çështjet teknike – Grupi punues ka diskutuar për menaxhimin e spektrit frekuencor, për detajizimin e planit alternativ frekuencor i cili plotëson nevojat e Republikës së Kosovës duke

marrë parasysh koordinimin e frekuencave me shtetet fqinje sipas planit Gjeneva 2006. Gjatë diskutimeve të shumta grupi teknik ka dal me këto rekomandime për pjesën teknike të strategjisë:

1. Që për strategjinë për kalim në transmetim digjital në Kosovë të përcaktohen standardet teknike në DVB-T2 dhe MPEG-4, H.264.AVC.
2. Për procesin e arritjes së koordinimit të brendshëm për Planin frekuencor digjital tokësor të propozuar nga KPM, u rekomandua që të plotësohet me ndihmën e ekspertizës relevante për planifikime edhe me krijimin e rrjetave një frekuencore (SFN) për tërë territorin e Kosovës duke i shfrytëzuar ndarjet frekuencore të caktuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU) dhe alotmente të tjera për mbulim regional.
3. Të bëhen analiza për breza të caktuara frekuencore që të jenë të lira nga ndërhyrjet gjatë fazës testuese të cilën duhet ta përcaktojë KPM për të gjitha kanalet të ndara nga ITU.
4. Pas arritjes së koordinimit të brendshëm për planin frekuencor të hartohet plani i veprimit për procesin e koordinimit me shtetet fqinjë për të siguruar pajtueshmëri edhe nga ana e tyre. Ky proces është i domosdoshëm në mënyrë që kërkesa për ndryshim të rezultateve për Kosovën nga RRC-06 të bëhet plotësisht në harmoni me parimet e përcaktuara nga ITU për modifikime të planeve frekuencore.
5. Në kuadër të punës së GP teknik të bëhet edhe një analizë për të vlerësuar kapacitetet ekzistuese të shërbimeve mediale për zhvillim të mëtejshëm në platformat digjitale. Kjo analizë do t'i shërbejë KPM-së gjatë shqyrtimit të praktikave për përcaktimin e metodologjisë së licencimit të operatorëve për multipleks.

Grupi për çështjet ekonomiko shoqërore – Grupi punues për çështje ekonomiko shoqërore në takimet e mbajtura ka diskutuar kryesisht lidhur me analizën e kapaciteteve të shoqërisë Kosovare dhe mediave për ta përballuar financiarisht digjitalizimin si dhe analizën e parametrave ekonomike për përcaktimin e kostos së përgjithshme për implementimin e digjitalizimit.

Në punën e këtij grupi punues është diskutuar dhe analizuar gatishmërinë financiare dhe teknike të subjekteve transmetuese për kalim në transmetim digjital.

Grupi për informim dhe sensibilizim – Ky grup punues ka organizuar takime me subjekte transmetuese në regjionet e Kosovës, si dhe konferenca për media në Zyrën e KPM-së. Në këto takime është prezantuar raporti i shkurtër i punës së KPM-së lidhur me strategjinë për digjitalizim si dhe Raporti i Hulumentimit lidhur me gatishmërinë e televizioneve për transmetim digjital. Qëllimi i këtyre konferencave dhe takimeve ishte informimi dhe sensibilizimi i opinionit lidhur me procesin e digjitalizimit.

Në të gjitha këto grupe punuese përveç stafit të KPM-së janë përfshirë edhe përfaqësues nga:

TV Nacionale, AMPEK/TV Lokale, OSHP, Operatorë Kabllor, Rrjeti i TV stacioneve “Mreza”, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit, MEF, ASHAK, UP, AGPK, MTPT, KTTN, ART, ekspertë për çështje të digjitalizimit, Oda Ekonomike e Kosovës, KPJ dhe sektori privat.

KPM ka angazhuar një kompani që ka shërbyer si sekretariat për koordinimin dhe organizimin e punëve dhe takimeve të grupeve punuese.

2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës

2.1 Lëshimi i licencave të reja – Më 30 qershor 2010, KPM ka përfunduar në tërësi procesin e licencimit afatgjatë. Si rezultat i këtij procesi, 104 subjekte transmetuese (radio dhe TV) janë pajisur me licencë afatgjatë. Pas përfundimit të licencimit afatgjatë, që ka rezultuar me 104 ST të

licencuara (21 TV dhe 83 radio) është bërë rishikimi i planit frekuencor analog për të vlerësuar disponueshmërinë e frekuencave të lira. Qëllimi ishte që të mundësohet qasje në media edhe në ato zona të Kosovës për të cilat vlerësohet se ekziston nevojë për sinjal radio-televiziv. Po ashtu, janë bërë edhe analizat e mbulueshmërisë në terren. Ky proces ka rezultuar me rekomandimet konkrete për licencime të reja duke marrë në konsideratë:

- lokacionet të cilat aktualisht nuk kanë qasje në një medium lokal;
- lokacionet në të cilat mungon çfarëdo sinjali medial televiziv (mungon edhe sinjali i mediave nacionale);
- lokacionet ku ekziston nevoja për shumëllojshmërie programore;
- komunat e reja të krijuara; si edhe
- kërkesat që janë parashtruar në KPM gjatë katër viteve të fundit për të analizuar cilat janë nevojat (duke marrë për bazë kriteret e cekura më lartë).

Analiza e disponueshmërisë së frekuencave të lira është bërë gjatë muajit shtator 2010, ndërsa janë identifikuar këto lokacione të cilat kanë nevojë për subjekte transmetuese: Dragashi, Reçani, Mitrovica, Podujeva, Lipjani, Hani i Elezit, Juniku dhe Prishtina.

Situata e jashtëzakonshme politike e krijuar në Republikën e Kosovës, pas shpërbërjes së Kuvendit dhe skadimi i mandatit të katër anëtarëve të Këshillit të KPM-së, ka ndikuar në ndërprerjen e procesit të lëshimit të licencave të reja. Në mungesë të kuorumit të anëtarëve të Këshillit për të marrë çfarëdo vendimi, është vendosur që të mos procedohet më tutje rreth lëshimit të licencave të reja, deri në konsolidimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e më pas edhe emërimin e katër anëtarëve të rinj të Këshillit të KPM-së. Prandaj, lëshimi i licencave të reja mbetet një prej aktiviteteve të KPM-së për vitin 2011.

2.2 Përmbushja e obligimit kushtetues për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe - Që në shkurt 2010 ka filluar takimet Këshilli Drejtues i krijuar për të punuar në realizimin e kërkesës kushtetuese për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe. Udhëheqës i këtij Këshilli Drejtues u caktua Ambasadori Gjerman, z. Steinbach, na kapacitetin e tij personal me kërkesë të Kryeministrit të Kosovës dhe Udhëheqësit të Zyrës Civile në Kosovë (ICO). Komisioni i Pavarur për Media është anëtare e këtij Këshilli së bashku me përfaqësues të Kuvendit, Qeverisë, transmetuesit publik, AMPEK-ut, televizioneve lokale dhe asociacioneve të mediave kosovare në gjuhën serbe. Takimet e Këshillit Drejtues kanë qenë të rregullta dhe me agjendë të qartë: *të shqyrtohen opsionet dhe mundësitë e paraqitura nga të gjithë anëtarët duke konsideruar një vizion të përbashkët për të krijuar një kanal televiziv të ri për serbisht-folësit e Kosovës.*

Është arritur marrëveshja që brenda këtij Këshilli të krijohen dy grupe punuese: a) për çështje institucionale, udhëhequr nga ICO, dhe b) për çështje teknike, udhëhequr nga KPM-ja.

Grupi Punues institucional është takuar disa herë dhe në fund ka dal me një rekomandim konkret që televizioni i ri:

- 1) të jetë televizion publik;
- 2) të jetë nën ombrellën e një sistemi të përgjithshëm të transmetimit publik në Kosovë; dhe
- 3) të mos jetë pjesë e RTK-së por të ketë bashkëpunim të ngushtë me RTK-në.

Ky rekomandim duhet të fuqizohet me ndonjë vendim ligjor dhe pastaj i mbetet Grupit punues për çështje teknike që të punojë në gjetjen e modaliteteve për realizimin e këtij rekomandimi praktikisht.

Përderisa Kushtetuta kërkon që të sigurohet plan ndërkombëtar i frekuencave për ta realizuar këtë, KPM që nga fillimi i diskutimeve ka sqaruar që në Kosovë nuk është e mundur të krijohet rrjeti i katërt televiziv nacional për faktin që nuk ka frekuenca në dispozicion të koordinuara me shtetet fqinje. Kjo ka qenë arsyeja pse RTK deri më tani nuk ka kanal in e dytë. Opsion teknik i realizueshëm dhe i mundshëm, deri në kohën kur duhet të bëhet kalimi (*switch-off*) i sistemit aktual analog dhe kalimit në digjitalizim, është transmetimi përmes kabllor. Sidoqoftë krijimi i mundësisë alternative teknike do t'i mbetet në obligim Grupit Punues Teknik.

Një gjë që është diskutuar në secilin takim dhe që mbetet ende problematikë në vete dhe pa ndonjë zgjidhje për momentin është fakti që pavarësisht se në çfarë formati përfundimtar do të jetë ky televizion i ri kosovar publik, do të bart në vete një problem kyç që po e përcjell edhe transmetuesin e vetëm të tanishëm, RTK-në, ai i sigurimit të financimit të qëndrueshëm e të pavarur. Prandaj, pikërisht pse është obligim kushtetues, të gjithë akterët e përfshirë në këtë mision duhet të angazhohen maksimalisht që në fund të krijojnë një televizion të ri i cili nuk do të shuhet edhe pas përfundimit të asistencë financiare të institucioneve ndërkombëtare që tani kanë shpreh gatishmërinë për kontribut, por që do të jetë një televizion i qëndrueshëm dhe në shërbim të popullatës kosovare të cilit do t'ia dedikojë programin.

2.3 Licencimi i operatorëve kabllorë në veriun e Kosovës – edhe gjatë vitit 2010, KPM ka vazhduar komunikimin me përfaqësuesit e operatorëve kabllor serb, duke i udhëzuar ata që të aplikojnë për licencë të KPM-së me qëllim që të vejnë në funksion punën e tyre në mënyrë ligjore. Pavarësisht udhëzimeve të shumta dhe komunikimeve, asnjë nga operatorët kabllor serb që operojnë ilegalisht në pjesën veriore nuk ka aplikuar për licencë të KPM-së. Gjatë vitit 2010 KPM ka licencuar një operator kabllor në pronësi të një kandidati nga minoriteti serb, i cili tani më funksionon ligjërisht në Graçanicë.

Rrethanat politike të krijuara në pjesën veriore të Republikës së Kosovës dhe ato të sigurisë, kanë qenë pengesë kryesore për KPM që të vë legjislacionin mbi operatorët kabllorë që veprojnë ilegalisht në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, angazhimi për të licencuar operimet kabllorë ilegale do të jetë një prej prioriteteve të KPM-së edhe në vitin 2011.

3. Promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese

3.1 Zbatimi i Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale - Pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2010 të kësaj rregulloreje të cilën Këshilli i KPM-së e ka miratuar në muajin gusht të vitit 2009, KPM ka monitoruar në vazhdimësi pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese dhe ofruesve të shërbimeve programore (OSHP) me këtë rregullore. Me monitorimet dhe masat ligjore që janë ndërmarr ndaj të licencuarve që janë gjetur në shkelje, është arritur që shumica e subjekteve transmetuese të vijnë në pajtueshmëri me këtë rregullore. Përfundim këtu bënë transmetuesi publik RTK i cili në vazhdimësi ka transmetuar komunikimet komerciale në kundërshtim me këtë rregullore. Për këto shkelje Këshilli i KPM-së ka nxjerrë tre vendime sanksionuese me gjobë të cilat janë vërtetuar edhe nga BAM-i pas shqyrtimit të ankesave të tyre në dy seanca të ndara.

4. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht

4.1 Rishikimi dhe plotësimi i legjislacionit sekondar - Që nga fundi i vitit 2006, kur edhe është themeluar Komisioni i Pavarur për Media, me funksionalizimin e organit vendimmarrës-Këshillit,

KPM ka punuar në krijimin e infrastrukturës ligjore për veprimtarinë transmetuese në Kosovë. Pas 3 vitesh funksionimi skena mediale ka ndryshuar dukshëm dhe ka lind nevoja që në përgjithësi të bëhet një rishikim i akteve nënligjore ekzistuese. Kështu që, gjatë vitit 2010 KPM ka rishikuar dhe amandamentuar Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-vizuale si dhe Rregulloren për ritransmetimin e kanaleve radiotelevizive në rrjetin kabllor.

4.2 Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale¹ – Deri me tani, Shërbimet Mediale Audio-Vizuale kanë vepruar në pajtim me Kodin e Sjelljes të nxjerrë në vitin 2000, i cili është bazuar në parimet e pranueshme evropiane, mirëpo gjatë zbatimit është vërejtur nevoja e plotësimit dhe ndryshimit të tij, kurse që nga 15 dhjetori 2010 në fuqi është Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale) i nxjerrë nga Këshilli i KPM-së. Drafti final i miratuar nga Këshilli i KPM-së, në pajtim me procedurat e KPM-së është dërguar te Shërbimet Mediale Audio-Vizuale për komente. Gjatë kësaj periudhe lidhur me draftin është diskutuar gjithashtu me konsulentët ndërkombëtarë nga kompania konsulente “Albany Associates” nga Londra, të cilët kanë ofruar konsultat e tyre lidhur me draftin. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë pranuar edhe komente nga Shërbimet Mediale Audio-Vizuale të cilat Këshilli i KPM-së i ka marr parasysh gjatë finalizimit të Kodit.

4.3 Rregullorja për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-vizuale² – Kjo rregullore ka hyrë në fuqi me datën 1 janar 2011. Ligji për KPM përcakton që taksa për licencë mund të shqyrtohet çdo dy vite dhe varësisht prej rrethanave të krijuara edhe të ndryshohet. KPM bazuar në të dhënat e azhurnuara që kanë qenë si rezultat i licencimit afatëgjatë ka vlerësuar domosdoshmërinë për ndryshimin e Vendimeve CIMC-2007/05 dhe CIMC 2008/01 dhe zëvendësimin e tyre me një rregullore e cila do të përcaktonte nivelin e taksës vjetore për licence për të gjitha shërbimet mediale audio-vizuale, përfshirë edhe operatorët e rrjeteve kabllore.

KPM përmes kësaj rregulloreje ka caktuar tarifat e reja për taksën për licencë për shërbimet mediale audio-vizuale. Me këtë rregullore është paraparë edhe kategoria e subjekteve transmetuese regjionale si rezultat i kërkesës së disa subjekteve transmetuese për zgjerim të zonës së mbulimit.

Me këtë rregullore është paraparë që taksa për Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP) të jetë e njëjtit nivel me subjektet transmetuese regjionale, pasi që edhe mbulueshmëria e tyre është përafërsisht e njëjtë.

Drafti final i kësaj rregulloreje i miratuar nga Këshilli i KPM-së është dhënë për komente të publikut dhe brenda periudhës së paraparë KPM ka pranuar komente të cilat janë shqyrtuar dhe inkorporuar. Gjithashtu lidhur me draftin është diskutuar me konsulentët ndërkombëtarë nga kompania konsulente “Albany Associates” nga Londra, të cilët e kanë vlerësuar nivelin e taksës të arsyeshëm krahasuar me nivelin e taksave në rajon.

Më poshtë janë dhënë tabelat përmes së cilave shihen ndryshimet në tarifat e taksës vjetore për licencë.

¹ Shih shtojcën 2 - Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale

² Shih shtojcën 3 - Rregullorja për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-vizuale

Tab.1 Krahasimet e taksës vjetore për subjektet transmetuese tokësore

| Lloji i subjekteve transmetues tokësore | Taksa vjetore (€) sipas: | | Ndryshimi | |
|---|--------------------------|-------------|-----------|-------|
| | Vendimi 2008/01 | Rregullorja | (€) | % |
| Radio me fuqi të ulët | 135.00 | 240.00 | 105.00 | 77.78 |
| TV me fuqi të ulët | 385.00 | 360.00 | -25.00 | -6.49 |
| Radio lokale | 395.00 | 540.00 | 145.00 | 36.71 |
| TV lokale | 650.00 | 810.00 | 160.00 | 24.62 |
| Radio regjionale | NUK KA PASUR | 1,260.00 | 1,260.00 | / |
| TV regjionale | NUK KA PASUR | 1,890.00 | 1,890.00 | / |
| Radio nacionale | 7,752.00 | 10,560.00 | 2,808.00 | 36.22 |
| TV nacionale | 11,628.00 | 15,840.00 | 4,212.00 | 36.22 |

Tab.2 Krahasimet e taksës vjetore për Operatorët Kabllor

| Komunat | Taksa vjetore (€) sipas: | | Ndryshimi | |
|--|--------------------------|-------------|-----------|-------|
| | Vendimi 2007/05 | Rregullorja | (€) | % |
| Prishtina | 7,258.06 | 8,884.00 | 1,625.94 | 22.40 |
| Prizreni | 3,120.97 | 3,932.00 | 811.03 | 25.99 |
| Ferizaj, Mitrovica, Peja, Gjilani, Gjakova, Podujeva | 1,596.78 | 2,012.00 | 415.22 | 26.00 |
| Komunat tjera dhe zonat kadastrale | 423.39 | 533.50 | 110.11 | 26.01 |

Tab.3 Krahasimet e taksës vjetore për Ofruesit e Shërbimeve Programore

| Lloji OSHP i | Taksa vjetore (€) sipas: | | Ndryshimi (€) | |
|--------------|--------------------------|-------------|---------------|-----|
| | Vendimi 2007/05 | Rregullorja | (€) | % |
| Radio | 1,260.00 | 1,260.00 | 0.00 | 0 |
| TV | 3,780.00 | 1,890.00 | -1,890.00 | -50 |

4.4 Rregullorja për operimet në sistemin kabllor – operatorët aktivë kabllorë kanë kaluar në sistem të avancuar digjital. Në relacion me operimet kabllore, ka ndodh që industria ka ec para se të krijohet baza ligjore për rregullimin e tyre dhe KPM ka arritur që për një kohë të shkurtër të nxjerr rregulloren e përshtatshme për funksionimin e operatorëve kabllor. Mirëpo, edhe zhvillimi i tyre teknologjik e edhe zhvillimet tjera mediale paraqesin nevojën që kjo kornizë ligjore të plotësohet dhe të ketë ndarje të qarta të sistemeve të transmetimit.

Duke marr parasysh ndjeshmërinë e fushës që rregullon kjo rregullore, KPM ka filluar procesin konsultativ që në maj të vitit 2010 duke u dhënë mundësinë operatorëve kabllorë të licencuar si edhe OSHP dhe subjekteve transmetuese që të jenë pjesë e procesit të amendamentimit dhe të paraqesin komentet dhe argumentet e veta për ndryshimet e nevojshme. Për ta fuqizuar procesin e nxjerrjes së një rregulloreje të re për këto operime dhe për të siguruar aplikueshmëri në Kosovë, KPM në bashkëfinancim me IREX ka angazhuar kompaninë konsulente ndërkombëtare “Albany Associates” për të bërë rishikimin ligjor dhe për të paraqitur një rregullore të re të amendamentuar.

Nga të gjitha palët e përfshira në këtë proces, është rekomanduar që kjo rregullore të detajohet edhe më tej. Po ashtu edhe vet KPM, duke u ballafaquar më ndërlikueshmërinë e rregullimit të kësaj fushe, ka vendosur që t’i kushtojë me shumë kohë dhe vëmendje ndryshimeve të bëra me të vetmin qëllim që rregullorja e re të vendos bazë të qëndrueshme ligjore e cila është e implementueshme dhe lehtë e zbatueshme nga operatorët kabllor.

5. Ngritja e kapaciteteve për monitorim të programeve

Nga fundi i vitit 2009, ka filluar edhe realizimi i Projektit të Monitorimit Statik, projekt i bashkë-financuar nga Instrumenti i Para Anëtarësimit (IPA 2009) në vlerë prej 1,000,000.00 (një milion) Euro dhe Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 100,000.00 (një qind mijë).

Realizimi i pjesës kryesore të këtij projekti nga fundi i vitit 2010, ka mundësuar krijimin e sistemit të monitorimit e me këtë monitorimin proporcional të të gjitha subjekteve transmetuese që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Kjo po i mundëson DMA-së monitorim më efikas dhe më të detajuar e gjithashtu mundëson analizimin dhe vlerësimin e programeve të transmetuara, përmes të cilave KPM krijon një pasqyrë të qartë lidhur me llojet e programeve, vlerësimin e cilësisë programore të subjekteve transmetueses dhe monitorimin e pajtueshmërisë me rregulloret e KPM-së.

Sipas projektit, ky sistem monitorimi siguron që nga 5 qendra të Republikës së Kosovës të mbliidhen të dhënat për të gjitha programet e transmetuara brenda 24 orësh, të cilat pastaj arkivohen në qendrën kryesore në Prishtinë. Ky sistem i monitorimit mundëson incizimin dhe arkivimin e programeve të transmetuara 24 orë në ditë varësisht nga nevojat e KPM-së. Pasi që në projekt nuk është përfshirë edhe qendra e gjashtë për arkivim të programeve të transmetuara nga subjektet e transmetuara në Ferizaj, projekti vazhdon edhe për vitin 2011.

PJESA II

OBJEKTIVAT E KPM-SË PËR VITIN 2011

Objektivat e paraqitura për vitin 2011 janë vazhdimësi e punës së filluar në vitin 2010, gjatë së cilës janë vendosur themelet e qëndrueshme për realizim të suksesshëm të objektivave si më poshtë:

1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës;
2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe
3. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

1. Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës

Një nga objektivat më të rëndësishme të KPM-së për vitin 2011, do të jetë finalizimi i Strategjisë për Digjitalizim. Gjatë vitit 2011, KPM së bashku me të gjitha palët e interesit, institucionet relevante shtetërore, shërbimet audio-vizuale dhe shoqërinë civile do të fokusohen në përmblylljen e punës për hartimin e kësaj strategjie, në mënyre që të mund të realizojë këtë projekt nacional në fushën e transmetimit.

Gjatë vitit 2011, KPM do të angazhojë grupet punuese të cilat do të finalizojnë Strategjinë për kalimin nga transmetimi analog në atë digjital. Para finalizimit të kësaj strategjie, KPM do të iniciojë koordinimin e planit frekuencor me shtetet fqinje. Me interes të veçantë dhe të domosdoshëm për këtë procesin e digjitalizimit është edhe anëtarësimi i Republikës së Kosovës në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), prandaj duke qenë udhëheqës i këtij procesi, KPM në bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës do të iniciojë edhe kërkesën për anëtarësim në ITU.

Duke marr parasysh faktin se me kalimin në transmetim digjital do të shfrytëzohet teknologji e re për pranim të sinjalit televiziv, ashtu siç ka ndodhur në shumë shtete tjera, KPM do të zhvillojë një kampanjë informuese për të ofruar informacione të detajuara tek qytetarët e Kosovës lidhur me përparësitë që ofron transmetimi digjital.

2. Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës

2.1 Lëshimi i licencave të reja në rrjetin analog - KPM ka vlerësuar se në disa lokalitete të Kosovës, qytetarët nuk kanë qasje të mjaftueshme në media të cilat do t'ju ofronin atyre informacione me karakter lokal apo të përgjithshëm. Bazuar në këtë, pas përfundimit të procesit të licencimit afatgjatë, KPM ka bërë rishikimin e planit frekuencor analog dhe ka identifikuar frekuencat e lira, në ato zona ku ka vlerësuar se ekziston nevoja për sinjal radio-televiziv, për çka Komisioni i Pavarur për Media gjatë vitit 2011 do të nxjerr në konkurs frekuenca të lira.

2.2 Licencimi i operatorëve kabllorë në veriun e Kosovës – Angazhimi për të licencuar operimet kabllorë ilegale do të jetë një prej prioriteteve të KPM-së edhe në vitin 2011, por për realizimin e këtij objektiivi nevojitet edhe përkrahja e institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

3. Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht

Duke qenë se transmetimi po ofrohet tek shfrytëzuesit në forma dhe mënyra të ndryshme, të ndara apo të konvergjuara, si rezultat i zhvillimeve të hovshme teknologjike po paraqitet nevoja, po edhe sfida, që të ndryshojë edhe mënyra e rregullimit përmes sjelljes së akteve të reja apo rishikimit të bazës ligjore ekzistuese dhe përafrimit të tyre me standardet evropiane. Një faktor shtesë për këtë është edhe synimi ynë në rrugën tonë drejt integritimeve në BE.

Duke ndjekur një praktikë të tillë të adaptimit, në përgjithësi KPM ka përmbushur në mënyrë të suksesshme misionin e vet rregullativ në aspektin ligjor duke realizuar vit pas viti objektivat e përcaktuara institucionale. Njëjtë, KPM do të vazhdojë këtë praktikë edhe gjatë vitit 2011 duke u fokusuar në realizimin e objektivave të përcaktuara më parë, sikurse:

3.1 Rregullorja për operatorë kabllorë - për të krijuar ambient të qëndrueshëm për zhvillimin e platformës kabllorë, KPM do ta shqyrtojë draftin në fazën përfundimtare konsultative me palët me interes për ta miratuar dhe fuqizuar. Tashmë bëhen tri vjet që kur KPM arriti me sukses të sjellë nën kornizën ligjore operimet transmetuese në rrjetet kabllorë. Sidoqoftë, duke qenë se vet operatorët e

rrjetit kanë kaluar nëpër një proces transformues zhvillimor teknologjik dhe për shkak të problemeve të paraqitura me ofertat programore ku të drejtat autoriale viheshin në pyetje, ka lind nevoja për ndryshim të bazës ligjore për këtë platformë. Me amandamentinin e Rregullores do të tejkalohen problemet që janë shfaq gjatë implementimit.

3.2 Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore – KPM do të bëjë harmonizimin e kësaj Rregulloreje me Ligjin për Kinematografinë. Ndryshimi do të fokusohet në periudhën e shikueshmërisë më të madhe, në të cilën kategorizimi i përmbajtjes programore dhe orari i transmetimit të programeve do të jetë në harmoni me Ligjin për Kinematografi.

PJESA III

PREZANTIMI I PUNËS SË KËSHILLIT TË KPM-së

Përbërja dhe Nominimet

Në vitin 2010 Këshilli i KPM-së ka vepruar në këtë përbërje: Filloreta Bytyqi kryetare, Daut Demaku nënkryetar, Venera Hajrullahu, Agim Sopi, Sadija Nikshiq dhe Ramë Bajraktari.

Këshilli i KPM-së gjatë këtij viti ka funksionuar me përbërje jo të plotë, për faktin se që nga data 28 gusht 2008 nuk është emëruar anëtari i shtatë (7) që nominohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Pasi që katër anëtarëve të Këshillit të KPM-së do t'iu përfundonte mandati më 15 dhjetor 2010, Zyra e Shefit Ekzekutiv në vitin 2010 filloi procesin e nominimeve, në pajtim me Ligjin e KPM-së për procedurën e nominimeve dhe emërimeve të reja. Ftesa publike për nominime është bërë më 8 shtator dhe ka përfunduar më 30 shtator 2010. Në mungesë të nominimeve të mjaftueshme për anëtarë të Këshillit të KPM-së, dhe në mënyrë që të silllet në pajtueshmëri me kërkesat ligjore që Këshilli të reflektojë shoqërinë multi-etnike në Kosovë, Zyra e Shefit Ekzekutiv ka vazhduar afatin për nominime edhe për dy javë (prej 4 deri më 30 tetor 2010).

Në të dy afatet e publikuara u pranuan gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) nominime, të cilat u publikuan dhe u dërguan për komente publike, ashtu siç kërkohet me procedura ligjore. Zyra e Shefit Ekzekutiv, më 01 nëntor 2010 ka përmbushur obligimin e saj ligjor duke i dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës listën me emrat e tetë kandidatëve më të kualifikuar, prej të cilëve do të emërohen 4 anëtarë të Këshillit të KPM-së.

TAKIMET DHE VENDIMET E KËSHILLIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA GJATË VITIT 2010

Gjatë vitit 2010 janë organizuar dhe mbajtur 20 takime të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media (KKPM).

Këshilli ka miratuar Rregulloren për Mënyrën dhe Nivelin e përcaktimit të Taksës për Licencë, Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale në Kosovë dhe ka marrë vendime për licencimin e 20 subjekteve transmetuese, 17 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP) dhe 3 Operatorëve Kabllor (OK).

Në këtë periudhë, Këshilli i KPM-së gjithashtu ka nxjerrë 31 Vendime kundër subjekteve transmetuese për shkeljet e bëra. Prej 31 Vendimeve kundër subjekteve transmetuese për shkeljet e bëra, 3 prej tyre janë nxjerrë për subjektet transmetuese të cilat janë gjetur në shkelje të Kushteve dhe Termave të Përgjithshme të licencës, 3 për subjektet transmetuese që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale, 12 vendime sanksionuese të nxjerra gjatë vitit 2010 për revokimin e licencave ndaj subjekteve transmetuese që kanë dështuar të kryejnë obligimin e pagesës së taksës për licencë, 2 vendime ndaj subjekteve që nuk kanë aplikuar fare për licencë afatgjate për transmetim, 4 vendime sanksionuese ndaj subjekteve transmetuese që janë gjetur në shkelje të Vendimit CIMC 2007/5 për Mënyrën dhe Nivelin e përcaktimit të taksës për licencë si dhe 7 vendime ndaj subjekteve transmetuese që janë gjetur në shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në janar 2010, Këshilli i KPM-së ka marrë vendim për përcaktimin e afatit përfundimtar për instalimin e filtrit dalës të transmetuesit nga ana e subjekteve transmetuese, i cili ishte një prej kriterëve kryesore teknike për dhënien e licencës së KPM-së.

Gjatë këtij viti, Këshilli ka pasur një angazhim të madh në përcaktimin e planit të punës së grupeve punuese për Hartimin e Strategjisë për Digjitalizim dhe ka vepruar në funksion të zbatimit të këtij plani.

RREGULLORET E MIRATUARA NGA KËSHILLI I KPM-SË

Gjatë vitit 2010, Këshilli i KPM-së ka miratuar dy akte nënligjore:

- *Kodin e Sjelljes për Shërbime Mediale Audio-vizuale, dhe*
- *Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-vizuale.*

Tekstet e këtyre rregulloreve janë dhënë në shtojca të raportit vjetor.

ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE

Duke filluar nga 7 deri më 11 qershor 2010, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) organizoi takime me përfaqësuesit e subjekteve transmetuese në pesë regjionet e Kosovës (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan).

Njoftimi i subjekteve transmetuese me realizimin e objektivave të parashtruara nga KPM për vitin 2009, arritjet, zhvillimet dhe aktivitetet në të gjitha Departamentet e këtij Rregullatori ishin qëllim i organizimit të këtyre takimeve, të cilat ishin vazhdimësi e takimeve regjionale me subjektet transmetuese të mbajtura në shtator të vitit të kaluar.

Këto takime ishin rast i mirë që udhëheqësit e Departamenteve të Licencimit, Monitorimit, Departamentit Ligjor dhe atij për Menaxhim Frekuencor, përmes prezantimeve të tyre të njoftojnë subjektet transmetuese me përmbylljen dhe rrjedhën e procesit të licencimit afatgjatë, përmbushjen e kriterëve e teknike për pajisje me licenca afatgjate e gjithashtu edhe për gjetjet nga monitorimi për pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me rregulloret e nxjerra nga KPM.

Këto takime u mirëpritën nga subjektet transmetuese dhe u cilësuan si shumë të dobishme. U dhanë në to shumë përgjigje për çështjet të cilat i shqetësojnë subjektet transmetuese dhe gjithashtu u shpalosën shumë tema me interes për subjektet transmetuese.

Ndërsa, në tetor 2010, KPM ka organizuar takime regjionale me subjektet e ndryshme transmetuese në të cilat subjekteve në fjalë iu është prezantuar puna e KPM-së në Hartimin e Strategjisë për Digjitalizim dhe Raporti i Hulumtimit “Vlerësimi i gatishmërisë së TV stacioneve në Republikën e Kosovës për kalim në transmetim digjital”.

KPM këto takime i ka parë shumë të rëndësishme për faktin që të diskutohet së bashku rreth digjitalizimit në Kosovë, duke zhvilluar kështu bashkëpunimin me subjektet transmetuese.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Bashkëpunimi me institucionet vendore është fuqizuar përmes Grupeve Punuese që u krijuan për hartimin e strategjisë për digjitalizim. Konsultat e ndërsjella ishin pjesë e proceseve të rëndësishme edhe në hartimin e kodit të sjelljes, rregullores për taksën për licencë dhe rregulloren për operimet kabllore (AMPEK, Ministria e Kulturës).

KPM ka arritur një Memorandum të Mirëkuptimit me ART-në për të fuqizuar bashkëpunimin institucional e me qëllim të definimit të saktë të obligimeve dhe ushtrimit të plotë të kompetencave të KPM-së dhe ART-së, në funksion të menaxhimit uniform dhe efikas të resurseve të kufizuara, burimeve spektrale (brezave frekuencore) nga autoritetet e parapara me ligjet aplikueshme.³

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Si rezultat i bashkëpunimit në mes të zyrës së IREX-it, World Learning dhe Zyrës së KPM-së në mars të vitit 2010 është realizuar një vizitë studimore në Zyrën e rregullatorit të mediave të Kroacisë. Qëllimi i vizitës ka qenë i orientuar në njohjen e stafit ligjor të KPM-së me zhvillimet e aspektit rregullativ e ligjor të institucionit homolog kroat. Gjatë kësaj vizite janë shkëmbyer përvoja dhe janë bërë krahasime në lidhje me funksionimin dhe kompetencat e rregullatorëve respektiv.

Nga 12 deri më 15 korrik 2010, dy anëtarë të Këshillit dhe 3 anëtarë të stafit të KPM-së të mbështetur nga OSBE, kanë realizuar një vizitë tek Rregullatori i Konvergjuar AGCOM në Itali. Qëllimi i kësaj vizite studimore, ishte këmbimi i përvojave nga fushat e ndryshme të rregullimit të mediave elektronike. Ekspertëve të kësaj agjencie rregullative, gjatë vizitës kanë bërë prezantime të shumta lidhur me ndërprerjen e transmetimit analog dhe kalimin në atë digjital, strategjia, si dhe aspektet teknike dhe ekonomike të tregut digjital.

Në kuadër të projektit të OSBE-së për të mbështetur KPM-në gjatë vitit 2010 janë angazhuar dy ekspertë nga rregullatori italian AGCOM për të kontribuar në procesin e draftimit të ligjit të KPM-së, si dhe në hartimin e strategjisë për digjitalizim. Arsyeja e angazhimit të këtyre dy ekspertëve nga shtetet e Bashkimit Evropian ishte që të vlerësohen dhe harmonizohen këto dy dokumente me direktivat dhe *aquis communautaire* të BE-së.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë me datën 15 dhjetor 2010, ka organizuar tryezën e rumbullakët me titullin “Strategjia për Digjitalizim, Sfidat dhe Zgjidhjet”, me ç’rast një ekspert nga Rregullatori i Italisë i informoi të pranishmit lidhur me përvojën e vendit të tij për Strategjinë për Digjitalizim si dhe ofroi shembuj nga strategjitë e vendeve të Bashkimit Evropian. Takimi kishte për qëllim të bashkojë TV stacionet, Operatorët Kabllor, Ofruesit e Shërbimeve Publike dhe anëtarët e Grupit Punues për

³ Shih shtojcën 6 - Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të KPM-së dhe ART-së

çështje teknike për Hartimin e Strategjisë për digjitalizim në mënyrë që të lehtësojë shkëmbimin e informatave në fushën teknike të Strategjisë.

Konsulenca ndërkombëtare ka vazhduar me vizitën e kompanisë “Albany associates” nga Londra, prej datës 29 nëntor deri më 3 dhjetor 2010. Kjo është realizuar me mbështetje të IREX. Si pjesë e vizitës, “Albany Associates” ka ofruar konsulencë për KPM-në lidhur me ndryshimet e mundshme në Rregulloren ekzistuese për operatorët kabllorë të KPM-së, Kodin e Sjelljes për shërbime Mediale-audiovizuale, dokumentet mbi dhënien e licencave konkurruese të transmetimit dhe strukturën e taksës së licencës. Konsulentët nga Albany Associates kanë dhënë komente të veçanta në një punëtori të mbajtur me stafin udhëheqës të KPM-së, në mënyrë që ato të përfshihen në draftet e ardhshme.

Në dhjetor 2010, në mbështetje të OSBE-së Zyra e KPM-së është pajisur me ITU Software, për të cilën është organizuar një trajnim për përdorim në ITU/Gjenevë për dy zyrtarë të KPM-së.

PJESA IV

PREZANTIM I PUNËS SË ZYRËS SË SHEFIT EKZEKUTIV

Personeli

Në fillim të vitit 2010, Zyra e KPM-së ka operuar me një staf prej 28 punëtorësh, ndërsa deri në fund të vitit 2010, numri i punëtorëve ka arritur në 31. Nga data 1 janar 2010 deri më 31 dhjetor 2010 janë rekrutuar gjithsej 4 punëtorë, prej tyre 2 punëtorë në Departamentin Ligjor, 1 punëtor në Departamentin e Monitorimit dhe 1 punëtor me kontratë afatshkurtër në pozitën e asistentit ekzekutiv. Ndërsa 1 punëtor ka dhënë dorëheqje nga posti.

Gjatë periudhës janar 2010 deri në dhjetor të vitit 2010 janë publikuar 5 shpallje dhe 4 rishpallje për këto vende të lira të punës: 1 shpallje për Asistent Ekzekutiv, 1 për Drejtor të Departamentit Ligjor, 1 për Menaxher për Monitorim Regjional, 1 për Zyrtar të lartë ligjor, 1 për Drejtor të Departamentit të Prokurimit, 1 rishpallje për Auditor të Brendshëm, 1 për Drejtor të Departamentit Ligjor dhe 1 rishpallje për Menaxher për Monitorim Regjional.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE

Ngritja e kapaciteteve (teknike dhe njerëzore)

Gjatë vitit 2009, Departamenti i Monitorimit dhe Analizave të KPM-së është pajisur me automjet me pajisje digjitale për monitorim përmbajtësor të subjekteve transmetuese, projekt kapital i financuar nga Buxheti i Kosovës. Automjeti posedon pajisje digjitale për monitorim në terren (me të gjitha pajisjet harduerike dhe softuerike), antena për pranimin e sinjalit, serverët me lidhje të VPN (Virtual Private Netëork) dhe rrjetë, si dhe me hapësirë të mjaftueshme për punë.

Në vazhden e përpjekjeve që Zyra e KPM-së po i bënë për avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të saj, në mars të vitit 2010, zyrtarët e DMA-së kanë vijuar trajnimin e avancuar për punën me pajisjet e instaluar në këtë automjet, mirëmbajtjen e tyre si dhe server-in ku do të ruhen të gjitha regjistrimet e programeve të subjekteve transmetuese të bëra në terren. Trajnimi ishte pjesë e projektit dhe është mbajtur nga kompania realizuese.

Nga fundi i vitit 2009, ka filluar edhe realizimi i Projektit të Monitorimit Statik projekt i bashkë-financuar nga Instrumenti i Para Anëtarësimit (IPA 2009) në vlerë prej 1,000,000.00 €(një milion Euro) dhe Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 100,000.00 €(një qind mijë Euro).

Realizimi i këtij projekti nga fundi i vitit 2010 ka mundësuar krijimin e sistemit të monitorimit e me këtë monitorimin proporcional të të gjitha subjekteve transmetuese që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Kjo i mundëson DMA-së monitorim më efikas dhe më të detajuar e gjithashtu ofron mundësi për analizim dhe vlerësim të programeve të transmetuara, përmes të cilave KPM krijon një pasqyrë të qartë rreth llojeve të programeve, vlerësimin e cilësisë programore të subjekteve transmetuese dhe monitorimin e pajtueshmërisë me rregulloret e KPM-së.

Sipas projektit, ky sistem monitorimi siguron që nga 5 qendra të Republikës së Kosovës të mbledhen të dhënat për të gjitha programet e transmetuara brenda 24 orësh, të cilat pastaj arkivohen në qendrën kryesore në Prishtinë.

Në nëntor të vitit 2010, stafi i DMA po ashtu ka ndjekur një trajnim 3 ditor lidhur me monitorimin e programeve të subjekteve transmetuese gjatë zgjedhjeve në të cilin janë trajtuar këto tema:

- Raportimi i drejtë dhe i paanshëm gjatë fushatës zgjedhore;
- Vlerësimi i raportimit- negativ, pozitiv, neutral dhe
- Përkrahja e sofistikuar për ndonjë parti politike.

Monitorimet

Monitorimi i pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale

Pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/4 nga 1 janari 2010, vlerësimi i Pajtueshmërisë me këtë Rregullore, ishte prioritet i Departamentit të Monitorimit dhe Analizave (DMA) të KPM-së. Pajtueshmëria me këtë Rregullore ishte prandaj fokus i monitorimeve të vazhdueshme të bëra nga DMA në vitin 2010.

Rregullorja për Komunikime Komerciale Audio-vizuale përcakton sasinë e komunikimit komercial si dhe parimet themelore të komunikimit komercial audio-vizual, teleshoppingut dhe sponsorimit për transmetimin e tyre tek ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale. Në monitorime janë përfshirë televizionet nacionale, televizionet lokale si dhe ofruesit e shërbimeve programore të cilët transmetojnë komunikime komerciale audio-vizuale.

Pajtueshmëria e RTK me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale

Sipas Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale, Radio Televizionit të Kosovës (RTK) i përcaktohen kufizime në sasinë dhe kohën për transmetimin e komunikimeve komerciale audio-vizuale. DMA ka monitoruar në vazhdimësi pajtueshmërinë e RTK-së me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale. Gjetjet nga dy monitorimet një mujore dhe disa monitorime tjera një javore kanë dëshmuar se edhe përkundër njoftimeve, vërejtjeve, dhe vendimit të KKPM për sanksionim me gjobë të RTK-së, Televizioni Publik i Kosovës ka vazhduar të transmetojë komunikime komerciale audio-vizuale në kundërshtim të plotë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-vizuale.

Pajtueshmëria e TV-21 dhe KTV me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale

Pas monitorimit të pajtueshmërisë me këtë Rregullore, në shkelje janë gjetur edhe dy televizionet tjera nacionale TV 21 dhe KTV. Televizioni 21 është gjetur në shkelje të nenit 15.3 të Rregullores për tejkallim të sasisë së reklamave, ndërsa KTV në shkelje për tejkallim të sasisë së reklamave dhe nenit 19 për vendosje të produkteve. Pas disa monitorimeve një javore për pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale, dërgimit të Njoftimeve për Shkelje, TV 21 dhe KTV, kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë.

Televizionet lokale dhe OSHP-të

Monitorimet e televizioneve lokale lidhur me pajtueshmërinë me Rregulloren e lartpërmendur kanë dëshmuar se televizionet lokale dhe ofruesit e shërbimeve programore kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Televizioni lokal TV Besa është i vetmi subjekt transmetues lokal i gjetur në shkelje, i cili pas Njoftimit për Shkelje dhe monitorimit të dytë ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë.

Monitorime të pajtueshmërisë me Rregulloren për Komunikime Komerciale janë bërë në vazhdimësi gjatë tërë vitit.

Monitorimi i pajtueshmërisë me Rregulloret tjera të KPM-së

Monitorimi i pajtueshmërisë së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore dhe me Kushtet dhe Termet e Licencës, ishin dy projekte tjera të realizuara nga DMA gjatë vitit 2010. Pas komunikimeve me subjektet transmetuese që janë gjetur në shkelje të kësaj rregulloreje dhe pas monitorimeve të radhës, ofruesit e shërbimeve mediale audio-vizuale kanë ardhur në pajtueshmëri me rregulloren në fjalë.

Një projekt tjetër i realizuar nga DMA ishte edhe Pajtueshmëria e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale me të drejtën e autorit. Ky projekt monitorimi u intensivikua gjatë kampionatit botërorë të futbollit të mbajtur nga 11 qershori e deri më 11 korrik 2010.

Në këtë periudhë vëmendje e posaçme i është kushtuar edhe monitorimit të pajtueshmërisë së operatorëve kabllor (OK) me Kushtet dhe Termet e Licencës së tyre dhe në veçanti identifikimit të kanaleve që ri-transmetohen nga OK e gjithashtu edhe vlerësimin nëse OK kanë të drejtën për ritransmetimin e tyre.

Monitorimi i Pajtueshmërisë me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së⁴

Nga fundi i vitit 2010, DMA ka bërë monitorimin e programit të subjekteve transmetuese, respektivisht vlerësimin e pajtueshmërisë së tyre me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së.

Vlerësimi i pajtueshmërisë së subjekteve transmetuese dhe OSHP-ve me Pjesën 3 të Kushteve dhe Termeve të Licencës, respektivisht me formatin e programit, është një aktivitet tjetër që i ka mundësuar KPM-së krijimin e një pasqyre më të saktë për pajtueshmërinë me skemën programore të subjekteve transmetuese. Këto monitorime janë bërë në kohën kur në KPM janë krijuar grupe punuese për hartimin e strategjisë së digjitalizimit e në veçanti grupit punues për program, i cili mëton krijimin e kornizave bazike dhe orientuese të përmbajtjeve programore, të cilën po e harton KPM-ja.

Monitorimi i programit në gjuhët e minoriteteve në RTK-së

⁴ Shtojca 7 - Raporti lidhur me pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me Pjesën 3 të Licencës

Transmetuesit publik kanë obligime të qarta karshi publikut. Një prej obligimeve të RTK-së, që del nga neni 6.6 i Ligjit për RTK-në, është transmetimi i programeve në gjuhët e minoriteteve. Pajtueshmëria e Televizionit Publik të Kosovës me Ligjin për RTK-në, respektivisht nenin 6.6 të këtij ligji, ishte prandaj theksi i monitorimeve të bëra nga DMA lidhur me sasinë e programeve të minoriteteve në RTK, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky. Monitorimi i kryer në shtator ka dëshmuar se përqindja e programeve për minoritete të transmetuara në Radio Televizionin Publik të Kosovës në periudhën monitoruese ishte 12.43% e jo 15% siç është e paraparë me Ligjin për RTK-në. Pas bisedimeve dhe vërejtjeve të bëra me menaxhmentin të RTK-së, gjetjet e DMA nga monitorimi i dytë tregojnë se RTK ka arritur sasinë e programit për minoritete të paraparë me nenin 6.6 të Ligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës.

Monitorimi i edicioneve të lajmeve të 3 TV nacionale

Monitorimet e rregullta të edicioneve qendrore të lajmeve në të tri televizionet nacionale në vitin 2010, janë vazhdimësi e projektit të vitit 2009, gjatë të cilit janë bërë monitorime një mujore të emisioneve të lajmeve në të tri televizioneve nacionale. Nga fillimi i këtij viti këto monitorime janë intensifikuar në monitorime të rregullta dy javore, të cilat bazohen në 7 kritere të njëjta, të përcaktuara për vlerësimin e performancës së tri televizioneve nacionale.

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave ka bërë gjatë kësaj periudhe edhe monitorime tjera pas ankesave lidhur me shkeljet e mundshme nga ana e transmetuesve. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij Departamenti pas realizimit të të gjitha projekteve të lartpërmendura, ishin bazë mbi të cilat Departamenti Ligjor, i Licencimit dhe ai i Menaxhimit Frekuencor, kanë mbështetur veprimet e tyre të mëtutjeshme.

Në periudhën raportuese stafi i këtij Departamenti ka bërë edhe shumë vizita e inspektime tek radiot, televizionet, operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimeve programore. Këto vizita janë shfrytëzuar nga zyrtarët për monitorim edhe për identifikimin e OK ilegal, pronarët e të cilëve janë udhëzuar të aplikojnë për licencë të KPM-së.

Monitorimi i medias gjatë zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Kosovës

Monitorimi i mediave elektronike gjatë fushatave zgjedhore ishte sfida më e madhe për DMA në vitin 2010. Pasi që Komisioni i Pavarur për Media është përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet nga të licencuarit (subjektet transmetuese dhe ofruesit e shërbimeve programore), DMA ka bërë monitorimin e programeve të subjekteve transmetuese gjatë periudhës së zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Rahovecit të mbajtura prej 10 deri më 21 nëntor 2010. Në monitorim janë përfshirë TV nacionale dhe TV lokale që operojnë në Regjionin e Prizrenit.

Gjithashtu, nga 1 dhjetori 2010 deri më 12 dhjetor 2010, DMA ka bërë edhe monitorimin e Zgjedhjeve të para Parlamentare në Republikën e Kosovës. Në monitorim janë përfshirë tri televizionet nacionale, të gjitha TV lokale dhe 2 Ofrues të Shërbimeve Programore. Përfshirjen e një numri kaq të madh në monitorim e ka mundësuar realizimi i projektit IPA 2010, projekt ky i bashkëfinancuar nga Komisioni Evropian dhe Buxheti i Kosovës.

Tetë (8) zyrtarë për monitorim të DMA të KPM-së, gjatë kësaj periudhe kanë bërë incizimin dhe analizimin e edicioneve qendrore të lajmeve, kronikave zgjedhore e reklamave politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe. Janë bërë gjithashtu matjet e hapësirës së dedikuar secilit entitet politik të certifikuar, duke i vlerësuar dhe kategorizuar këto prezantime si prezantime pozitive neutrale dhe negative. Në ditën e gjashtë të fushatës zgjedhore, DMA ka dal me një raport preliminar lidhur me performancën pesë-ditore të mediave elektronike.

Pas monitorimit të performancës së subjekteve transmetuese dhe OSHP-ve gjatë fushatës për Zgjedhjet e para Parlamentare në Republikën e Kosovës, DMA ka përgatitur gjithashtu raportin përmbledhës⁵.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Procesi i licencimit afatgjatë

Procesi i licencimit afatgjatë ka qenë një prej angazhimeve të KPM, i cili është planifikuar të përfundojë në fillim të vitit 2010. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, Departamenti i Licencimit (DLIC) ka përcjellë aktivitetet dhe obligimet lidhur me përmbylljen e procesit të licencimit afatgjatë, në veçanti për subjektet transmetuese të cilat nuk kishin arritur ta instalonin filtrin dalës si një prej kushteve teknike kryesore për licencim afatgjatë si dhe të atyre subjekteve transmetuese të cilat i përkisnin fazës së tretë për licencim (subjektet transmetuese me kërkesa teknike për ndryshime të theksueshme të parametrave teknik).

Për këto vonesa të gjitha subjektet transmetuese që bëjnë pjesë në këtë grup kanë paraqitur arsyet e tyre të cilat kanë të bëjnë kryesisht me çështje logjistike pasi që kemi të bëjmë me një pajisje e cila prodhohet jashtë Kosovës.

Për të përmbyllur në tërësi licencimin afatgjatë, Këshilli i KPM-së vendosi që të caktojë datën 31 qershor 2010 si afat të fundit për instalimin e filtrit dalës për subjektet transmetuese të cilat nuk kishin arritur ta përmbushin këtë obligim. Përmes të njëjtit vendim, pas datës së lartpërmendur, Këshilli i KPM-së i shpalli të pavlefshme të gjitha licencat e përkohshme, përfshirë edhe autorizimet speciale për subjektet transmetuese ndërkombëtare, për të cilat Këshilli i KPM-së ka përcaktuar një afat për aplikim për licencë afatgjate.

Gjithashtu, DLIC në kuadër të procesit të licencimit afatgjate ka trajtuar pesë raste për subjektet transmetuese, lidhur me mos aplikimin e tyre për licencë edhe pas afatit shtesë që ju ka ofruar Këshilli i KPM-së, si dhe një rast lidhur me mos kompletimin e dokumentacionit të aplikimit sipas pakos së aplikacionit për licencë afatgjate. DLIC përmes Shefes Ekzekutive i ka rekomanduar Këshillit që të revokojë licencat e këtyre subjekteve transmetues. Licencat e këtyre subjekteve transmetuese janë revokuar nga ana e Këshillit të KPM-së. Dy nga këto subjekte e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore për tu ankuar pranë Bordit për Ankesa të Mediave. Bordi ka shqyrtuar këto ankesa dhe pas shqyrtimit të tyre ka mbështetur vendimin e Këshillit për revokim të licencave të transmetimit.

Kërkesat për ndryshime të licencës

Si pjesë e procesit të licencimit afatgjatë kanë qenë edhe kërkesat për ndryshime të pronësisë si dhe kërkesa për ndryshim të emrit të subjekteve transmetuese si dhe të OSHP-ve.

DL ka pranuar katër kërkesa për ndryshim të pronësisë siç janë: OSHP Multi Vizion, OSHP Alsat Kosova, Radio Mega Vox dhe Radio Spektar. Gjithashtu, kërkesat për ndryshim të emrit të subjekteve transmetues ishin pesë sosh: OSHP Multivision (*News TV*), Radio Megavox (*Shqip FM*), Radio Spektar (*FWF City Radio*), Radio Leshak (*Radio Koreni*), OSHP Boom TV (*ETV*).

⁵ Shih shtojcën 3 – Monitorimi i medias elektronike gjatë fushatës për zgjedhje parlamentare 2010

Gjithashtu DLIC ka pranuar 2 kërkesa lidhur me ndryshimin e kushteve dhe termeve teknike të licencës: TV Vali dhe Radio Kontakt Plus.

Njoftimi për pagesën e taksës për licencë

Në fillim të vitit 2010, Këshilli i KPM-së mori vendim që afati i fundit për pagesën e taksës për licencë nga ana e subjekteve transmetuese të jetë data 5 mars 2010. Departamenti i Licencimit ka përcjell shkresat në formë të njoftimit të subjekteve transmetuese rreth afatit të pagesës së taksës për licencë duke iu theksuar edhe shumën për pagesë. Sipas të dhënave nga Departamenti i Administratës së KPM-së, pagesën e taksës për licencë nuk kanë arritur ta kryejnë katër subjekte transmetuese - radio dhe TV, si dhe pesë ofrues të shërbimeve programore. Për këto subjekte transmetuese është iniciuar procedurë ligjore.

Për shkak të vështirësive financiare, në pjesën e parë të viti 2010 kanë heq dorë nga licenca e KPM-së 2 ofrues të shërbimeve programore.

Kërkesat për licencë të KPM-së

Gjatë vitit 2010, DLIC ka pranuar 19 kërkesa për OSHP. Nga këto kërkesa, DLIC ka përcjellë para Këshillit të KPM-së rekomandime për licencimin e OSHP-ve. Një nga kërkesat për licencimin e OSHP, pronari i së cilës veç posedon një licencë për OSHP, LIC nuk e ka marrë në shqyrtim/vlerësim pasi që kandidati i cili ka parashtruar aplikacionin nuk ka vepruar në pajtim me vendimin CIMC 2007/05 pasi që nuk e ka kryer obligimin ndaj taksës për licencë për OSHP ekzistuese të licencuar (ON TV). Megjithatë, kandidati ka njoftuar me shkrim se nuk është i interesuar që të procedohet më tutje për licencim. Këshilli i KPM-së nuk ka marr vendim për licencim për një kërkesë tjetër, mirëpo ka kërkuar sqarim shtesë pasi që kandidati për licencë, ka qenë kandidat për deputet të një subjekti politik, çka është në kundërshtim me Rregulloren CIMC 2009/02. Prandaj, në këtë periudhë janë nxjerrë gjithsej 17 vendime për licencim të OSHP-ve. Gjithashtu është pranuar edhe 1 kërkesë për IPTV.

Brenda periudhës raportuese, DLIC ka pranuar tri kërkesa për licencimin e operatorëve kabllorë për lëshimin e të cilave ka rekomanduar Këshillin e KPM-së. Operatorët kabllor të licencuar në këtë periudhë janë: OK "Link Produkcija" – Graçanicë, OK "Dream" – Dragash dhe OK "NTP Kumanova" – Therandë.

Gjithashtu, Departamenti i Licencimit ka pranuar edhe 9 kërkesa për frekuenca/TV kanale. Të gjithë të interesuarve iu është sqaruar se Këshilli i KPM-së, ka marrë vendim që deri në përfundimin e procesit të licencimit afatgjatë nuk do të merr në shqyrtim kërkesat e tilla. Po ashtu është pranuar një njoftim për ndërprerje të transmetimit dhe një njoftim për ndërhyrje në frekuencë. Këto raste janë trajtuar nga DLIC dhe janë ndërmarr hapat të bazuara në procedurat e KPM-së deri në zgjidhjen e rasteve.

Departamenti i Licencimit, në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhim Frekuencor ka trajtuar një kërkesë që ka arritur nga komuniteti serb në Osojan, komuna e Istogut – Radio Bravo. Për këtë subjekt transmetues, më 11 gusht 2010 Këshilli ka vendos t'i lëshojë një licencë të përkohshme deri në rishikimin e planit frekuencor të KPM-së.

Në Kosovë aktualisht veprojnë 105 subjekte transmetuese të licencuara nga KPM, përfshirë edhe Radio Bravo e cila operon në bazë të licencës së përkohshme.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010, ka shqyrtuar raste të ndryshme të subjekteve transmetuese, ofruesve të shërbimeve programore dhe operatorëve kabllorë për shkelje të dispozitave të Ligjit 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin dhe akteve tjera nënligjore të KPM-së. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe ankesa të personave fizik e të organizatave të ndryshme që i janë drejtuar KPM-së, ndaj mediave elektronike.

Varësisht nga lloji i dispozitave ligjore, të shkelura nga subjektet transmetuese, rastet e proceduara janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

1. Rastet për transmetim ilegal

Gjatë vitit 2010, është proceduar një (1) rast për shkeljen e nenit 11.1 të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon Komisioni”*, dhe neni 20.5 i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë nuk mund të ankohet tek Bordi i Ankesave për Media”*.

Rasti i proceduar për shkeljen e dispozitave të lartpërmendura është i paraqitur në tabelën 1 të shtojcës V të këtij raporti dhe kanë të bëjnë me një (1) subjekt ilegal transmetues në regjionin e Gjakovës. Edhe pas dërgimit të Urdhrit për ndërprerje të transmetimit, subjekti transmetues i quajtur Radio Amadeus nuk ka ndërprerë transmetimin e programeve, kështu që më datën 4 nëntor 2010 i është konfiskuar pajisja e transmetimit. Rasti është i mbyllur.

2. Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KKPM 2009/04

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010, ka proceduar shtatë (7) raste⁶ kundër subjekteve transmetuese që janë gjendur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale:

- TV 21 ka bërë shkelje të nenit 15.3 të kësaj rregulloreje, tejkallim i minutazhit të lejuar për reklamim. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë.
- Radio Televizioni i Kosovës - RTK, ka bërë shkelje të nenit 15.2 të kësaj rregulloreje, transmetimi i reklamave në kohën e ndaluar për transmetuesin publik dhe Vendosja e produkteve gjatë transmetimit të emisioneve përkundër faktit që sipas rregullores së cekur këtë e ka të ndaluar. Edhe pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, nuk ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë për çka më datën 10 mars 2010, ka pasuar Vendimi i Këshillit të KPM-së me të cilin subjekti është gjobitur në shumën prej 50,000.00 Euro.
- Radio Televizioni i Kosovës - RTK, ka bërë shkelje të nenit 19.1 të kësaj rregulloreje, Vendosja e produkteve gjatë transmetimit të emisioneve, përkundër faktit që sipas rregullores së cekur këtë e ka të ndaluar. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, nuk ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë për çka më datën 10 mars 2010, ka pasuar Vendimi i Këshillit të KPM-së me të cilin subjekti është gjobitur në shumën prej 25,000.00 Euro.

⁶ Shih shtojcën 5 – Tabela e rasteve ligjore

- Radio Televizioni i Kosovës - RTK, ka bërë shkelje të nenit 15.2 të kësaj rregulloreje, transmetimi i reklamave në kohën e ndaluar për transmetuesin publik. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, dhe Vërejtjes, nuk ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë për çka më datën 28 shtator 2010 ka pasuar Vendimi i Këshillit të KPM-së me të cilin subjekti është gjobitur në shumën prej 50,000.00 Euro.
- KTV – Koha Vizion, TV Besa dhe TV ILIRIA kanë bërë shkelje të nenit 15.3 dhe 19.4 të kësaj rregulloreje, tejkalim i përqindjes së kohës, të lejuar për reklamim. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, subjektet transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren në fjalë.

3. Rastet për shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

3.1 Transmetimet pa të drejtë autoriale

Edhe gjatë vitit 2010, çështja e respektimit të të drejtës autoriale ka qenë problem kyç si për industrinë mediale ashtu edhe për rregullatorin. Mungesa e një institucioni përkatës për zbatimin e Ligjit mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili është shpallur në gusht të vitit 2006, vështirëson edhe më shumë punën e KPM-së pasi që edhe gjatë vitit 2010 vetëm KPM është marr me çështjet e respektimit të së drejtës autoriale nga subjektet transmetuese.

Subjektet transmetuese së bashku me operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimit të programeve e kanë obligim sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së që të respektojnë të drejtën e autorit dhe të sigurojnë kontrata valide për transmetimin e programeve komerciale dhe për kanalet e ritransmetuara (operatorët kabllorë).

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010, ka proceduar nëntë (9) raste për shkelje të së drejtës autoriale:

- Rasti ligjor ndaj Operatorit Kabllor Kujtesa Net, lidhur me Shkeljen e nenit 2.1.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, është vendosur nga Këshilli i KPM-së që Kujtesa të gjobitet në shumën prej 50.000,00 Euro. Rasti mbetet i hapur dhe bartet në vitin 2011, pasi që pala ka ushtruar Ankesë ndaj Vendimit të Këshillit dhe se rasti është në shqyrtim para BAM-it.
- Për shkelje të njëjta të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës janë iniciuar raste ndaj tetë (8) subjekteve transmetuese, TV Prizreni, Boom TV, Klan Kosova, OK Eagle, TV Men (në dy raste), TV Mitrovica dhe IPKO, të cilat pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje janë mbyllur si raste, pasi që palët kanë ardhur në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

3.2 Mos-mbajtja e arkivës

Dështimi i Palëve Përgjegjëse për sjelljen e materialit të arkivuar programor sipas kërkesës së KPM-së, ka rezultuar me iniciimin e tre (3) rasteve ligjore, ndaj TV MEN, TV Herc dhe Klan Kosova nga një rast. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, palët kanë ardhur në pajtueshmëri, kështu që rastet janë mbyllur.

4. Rastet për shkelje të Rregullores CIMC 2009/01 – për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010 ka proceduar 3 raste lidhur me shkeljen e Rregullores CIMC 2009/01. Për të gjitha rastet e evidentuara, subjekteve iu është dërguar Njoftim për Shkelje. Rastet janë mbyllur pasi që subjektet kanë ardhur në pajtueshmëri me kërkesat e KPM-së.

5. Rastet për shkelje të Vendimit CIMC-2008/01 për Subjekte Transmetuese – Mos-pagesa e taksës për licencë

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010 ka proceduar gjashtëmbëdhjetë (16) raste lidhur me këtë shkelje.

Nga këto raste për katër subjekte transmetuese, Radio Top Iliria, Radio Premiera, Radio Bubamara dhe TV Men, Këshilli i KPM u ka dërguar Vërejtje me shkrim me të cilën ju ka bërë me dije këtyre subjekteve se mos-pagesa e më tejme e taksës për licencë do të rezultojë me Revokim të Licencës. Rastet janë të hapura dhe barten për shqyrtim të mëtejme në vitin 2011.

Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje dymbëdhjetë (12) subjektet tjera kanë bërë pagesën e taksës për Licencë, kështu që rastet janë mbyllur.

6. Rastet për shkelje të Vendimit CIMC-2007/05 për OSHP dhe OK – Mos-pagesa e taksës për licencë

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010, ka proceduar dymbëdhjetë (12) raste lidhur me këtë shkelje:

Këshilli i KPM-së u ka dërguar Vërejtje me shkrim pesë (5) OSHP-ve, Bussines Channel 1, ON TV, TV Alba, Visa Channel dhe Pro Channel, për revokim të licencës në rast se edhe më tutje nuk bëjnë pagesën e taksës për Licencë. Rastet janë të hapura dhe barten për shqyrtim të mëtejme në vitin 2011.

Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjeve të KPM-së, 7 OSHP-të tjera kanë bërë pagesën e taksës për Licencë, kështu që rastet janë mbyllur.

7. Rastet për shkeljen e Ligjit Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e përgjithshme

Gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, Departamenti Ligjor ka proceduar dy (2) raste lidhur me këto shkelje.

Shkelje e nenit 49, pika 1 të Ligjit për Zgjedhjet - Reklamimi politik në kuadër të edicionit të lajmeve dhe Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale 2009/04.

Për shkeljen e nenit 49.1 është proceduar rasti i Klan Kosova, lidhur me reklamimin politik para fillimit të Fushatës Zgjedhore. Pas Njoftimit për Shkelje ky subjekt transmetues ka ardhur në pajtueshmëri. Rasti është mbyllur.

8. Shkelja e Heshtjes Zgjedhore

Bazuar në nenin 52 të Ligjit për Zgjedhje të përgjithshme është proceduar një (1) rast lidhur me shkeljet e Udhëzuesit nr. 3 për heshtjen e medieve gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Edhe përkundër dërgimit të Njoftimit për Shkelje Klan Kosova ka vazhduar që të jetë në shkelje ligjore, kështu që Këshilli i KPM-së më datë 15 dhjetor 2010 ka marrë vendim për ta gjobitur OSHP Klan Kosova në shumë prej 20,000.00 Euro. Rasti është i hapur dhe bartet për shqyrtim të mëtejme në vitin 2011.

9. Rastet e hapura për shkak të mosdorëzimit të Raportit vjetor financiar

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2010, ka proceduar 24 raste lidhur me mosdorëzimin e Raportit vjetor financiar. Pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje rastet janë mbyllur pasi që palët kanë sjellë raportet e cekura duke ardhur në pajtueshmëri me kërkesat e KPM-së.

10. Raste dhe Kërkesa tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2010

Janë proceduar dy (2) raste:

-Rasti i parë është proceduar bazuar në kërkesën e Partisë politike Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) ndaj OSHP Klan Kosova, për mos dhënie të drejtës për demant. KPM i ka dërguar Vërejtje më shkrim Klan Kosova për këtë rast, pasi që palës ankuese i ka dhënë hapësirë të pamjaftueshme për të shprehur opinionet e veta për sa u përket Zgjedhjeve të Përgjithshme.

-Rasti tjetër, është proceduar sipas ankesës së gazetarit të një gazete të përditshme sipas të cilit subjekti transmetues TV Besa në njërin nga emisionet e transmetuara ka bërë shpifje dhe fyerje ndaj gazetarit për punën e tij. KPM më 23 prill 2010, Lidhur me rastin subjektit TV Besa i është dërguar Vërejtje me shkrim.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Gjatë vitit 2010, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) ka organizuar takime me përfaqësuesit e subjekteve transmetuese, për shqyrtimin e kërkesave të tyre, kërkesa këto të pa pranueshme për planin frekuencor. Këto subjekte transmetuese janë: TV Mir, TV Puls, TV Most, Radio Kontakt Plus, Radio dhe TV Besa, Radio Helix, Top Radio, Radio Energji, TV Syri Vision, TV Vali, Radio Kosova e Lirë, Radio Vala Rinore, Radio Urban Fm, Radio Victoria, TV Tema, Radio Visioni.

Ndërsa të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me frekuenca shtesë si dhe ato që kanë të bëjnë me kalimin e transmetimit në pikat e transmetimit në nivel nacional janë refuzuar, bazuar në vendimin e Këshillit të KPM-së të datës 17 mars 2010.

DMF gjithashtu ka bërë analiza për të gjitha ato subjekte transmetuese të fazës së tretë të licencimit, dhe kërkesat që nuk kanë qenë në kundërshtim me planin frekuencor të cilin e posedon KPM (ndërrim lokacioni, rritje e fuqisë dhe parametrave tjera teknike) me rekomandim të DMF-së janë miratuar nga Këshilli i KPM-së.

Tabela lidhur me kërkesat e aprovuara të subjekteve transmetuese

| | Emri i Subjektit Transmetues | Kërkesat e aprovuara |
|---|-------------------------------------|--|
| 1 | Radio Kllokoti | Ndryshim Lokacioni |
| 2 | Radio Besa | Ndryshim Lokacioni |
| 3 | TV Besa | Ndryshim Lokacioni |
| 4 | TV Yeni Donem | Ndryshim Lokacioni |
| 5 | Radio Helix | Ndryshim Lokacioni |
| 6 | TV Opinioni | Ndryshim Lokacioni (ka qenë edhe më herët) |
| 7 | Radio Antena | Ndryshim Lokacioni dhe Rritje e Fuqisë |

| | | |
|----|--------------------|--|
| 8 | Top Radio | Ndryshim Lokacioni |
| 9 | Radio Yeni Donem | Ndryshim Lokacioni |
| 10 | Radio Gorazhdevci | Rritje e Fuqisë |
| 11 | Radio Plus | Rritje e Fuqisë |
| 12 | Radio KIM | Rritje e Fuqisë |
| 13 | Radio Vala Rinore | Rritje e Fuqisë |
| 14 | Radio Gora | Rritje e Fuqisë |
| 15 | Radio Omega 3 | Rritje e Fuqisë |
| 16 | Radio Borzani | Rritje e Fuqisë |
| 17 | TV Iliria | Rritje e Fuqisë |
| 18 | Radio Romano Avazo | Rritje e Fuqisë |
| 19 | Radio Fortuna | Rritje e Fuqisë |
| 20 | Radio As (Zveçan) | Rritje e Fuqisë |
| 21 | Radio Drenasi | Rritje e Fuqisë |
| 22 | TV Tema | Rritje e fuqisë si dhe shtimi i numrit të antenave |
| 23 | Radio Vitez | Zvogëlim i Fuqisë |

Me kërkesë të Këshillit të KPM-së, DMF ka bërë analiza dhe matje në terren për gjetjen e frekuencave të lira, posaçërisht në vendet ku ka mungesë të mbulimit me sinjal radio-televiziv të karakterit nacional ose lokal. Matjet janë kryer në Dragash, Kaçanik, Prishtinë, Mitrovicë, Podujevë, Reçan, Junik, Lipjan dhe Hani i Elezit.

Për të gjitha lokacionet e lartpërmendura DMF ka definuar parametrat teknik të transmetimit (frekuenca, koordinatat gjeografike, fuqia e transmetuesit, lartësia mbidetare, polarizimi i antenës dhe lartësia e antenës).

Rastet për interferenca

Gjatë vitit 2010, DMF nuk ka pranuar asnjë ankesë për interferenca nga subjektet transmetuese. Kjo do të thotë se gjendja në brezin frekuecor radio-difuziv në Kosovë është mjaft stabile, sidomos pas instalimit të filtrave dalës me rastin e procesit të licencimit.

Kërkesa për frekuenca të reja

Gjatë vitit 2010, nga kërkesat për frekuenca të reja janë miratuar vetëm dy, një për Radio Bravo, radio me fuqi të ulët në Osojan (zonë e pambuluar me radio sinjal lokal) dhe një për Radio KFOR.

Frekuencat në shfrytëzim nga UNMIK-u dhe KFOR-i

Nga monitorimet e bëra është gjetur se UNMIK-u vazhdon edhe më tutje të shfrytëzon frekuencën 106.5 MHz për mbulim të regjionit të Mitrovicës dhe frekuencën 107.2 MHz për mbulim të Prishtinës, Pejës, Gjilanit dhe shumë më gjerë. Që nga viti 2008, UNMIK ka njoftuar KPM që vazhdon shfrytëzim e tyre. Këto frekuenca nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë dhe se këto mund të paraqesin interferenca në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

Pika transmetuese e Goleshit - KFOR

Përveç shfrytëzimit të frekuencave për radio dhe TV, shfrytëzon si pikë transmetimi edhe Majën e Goleshit, e cila nuk shfrytëzohet nga mediat kosovare.

Sidoqoftë, gjatë vitit 2010 RTK i është drejtuar KFOR-it me një kërkesë lidhur me shfrytëzimin e pikës nacionale për transmetim Golesh, dhe për vendosjen e antenave transmetuese në kanal Ch 7. KPM ka qenë e përfshirë në këtë çështje me ofrimin e analizave për parametrat teknike dhe shkallën e interferencës. Një lëvizje e tillë konsiderohet si një hap pozitiv drejt ndryshimit të situatës me pikën e transmetimit nga Goleshi. Me aktivizimin e rrjetit për TV do të mundësohej përmirësimi i sinjalit të RTK-së dhe zgjerim më i madh mirëpo për t'u realizuar kjo me sukses duhet me shumë angazhim edhe i institucioneve tjera gjegjëse për implementim të ligjit të RTK-së sa i përket përqindjes së mbulueshmërisë.

Në pritje të vendimit për Goleshin, RTK ju drejtua KPM-së me një kërkesë që të transmetojë nga atje por jo në rrjetin analog të hapur por në sistem digjital. KPM i është përgjigjur se në këtë fazë dhe në pajtim me Ligjin e KPM-së, KPM nuk do të lejojë shfrytëzimin e frekuencave në majën e Goleshit për transmetim digjital. KPM-ja është në fazën e hartimit të draft-strategjisë për kalimin e transmetimeve TV analoge në ato digjitale, dhe në kuadër të finalizimit të Strategjisë do të vendoset edhe për parametrat teknik që do përdoren për të shfrytëzuar pikën e Goleshit.

KPM mbetet e përkushtuar dhe është në dispozicion në çdo kohë dhe bënë përpjekje që pika e lartë e Goleshit të vihet në funksion për qëllime të cekura më lartë, mirëpo fillimisht për transmetim analog në kanalet transmetues CH7, CH44 dhe CH48, në brezat frekuencor TV/VHF dhe TV/UHF/ në bandet IV dhe V të cilat janë të definuara në konferencën "Stokholm 61" dhe garantohet se nuk do të interferojnë në asnjë kanal ekzistues që operon me sistem analog të transmetimit, përfshirë edhe në kanalet televizive që operojnë jashtë kufijve të Kosovës.

Shfrytëzimi i pjesës së sipërme të Goleshit do t'u mundësonte mediave transmetuese, radio dhe TV, që të mbulojnë afërsisht edhe 12% më tepër të popullatës së Republikës së Kosovës (d.m.th. do të zgjidhej edhe çështja e mbulimit të RTK-së siç është e obliguar me ligj). Përdorimi i kësaj pjese do të mundësonte edhe mbulimin e pjesës veriore të Kosovës, të banuar kryesisht me popullatën minoritare serbe.

Ngritja e kapaciteteve

Gjatë vitit 2010, DMF ka ndjekur një trajnim (administrator të pajisjeve) në Gjermani dhe në Kosovë për punën me pajisjet digjitale të instaluar në automjetin për monitorim në terren të programeve radio dhe TV. Nga fundi i vitit 2010 ka filluar Implementimi i Projektit të ICS Manager - projekt kapital i financuar nga Buxheti i Kosovës. Ky sistem është kompatibil me softuerin ICS telecom V.9.1 që KPM-ja e përdor për planifikim frekuencor dhe analiza teknike. ICS Manager ka mundësi që të deponojë të gjitha të dhënat që ndërliidhen me menaxhimin e spektrit në mënyrë të lehtë dhe hierarkike ashtu që të menaxhojë dhe sigurojë në mënyrë automatike.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Buxheti

Komisioni i Pavarur për Media është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2010 KPM-së i është ndarë buxhet prej 1,115,788.00 Euro duke përfshirë të hyrat vetanake prej 188,344.00 euro dhe investimin kapital prej 460,000.00 Euro⁷.

⁷ Shih Shtojcën 1 – Raporti financiar për vitin 2010

| Buxheti i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2010 | | | |
|---|----------------------------|---------------------|----------------------|
| Kategoritë | Buxheti i alokuar/aprovuar | Buxheti i shpenzuar | Buxheti i paspenzuar |
| Paga dhe mëditje | 202,171.00 | 202,171.00 | 0 |
| Mallra dhe shërbime | 249,733.00 | 241,887.00 | 7,846.00 |
| Shërbime komunale | 15,540.00 | 15,093.00 | 447.00 |
| Të Hyra vetanake | 188,344.00 | 152,474.00 | 35,870.00 |
| Shpenzimet kapitale | 460,000.00 | 452,707.00 | 7,293.00 |
| Total | 1,115,788.00 | 1,064,331.00 | 51,457.00 |

Të hyrat vetanake për vitin 2010 të mbledhura prej taksës së licencës nga subjektet transmetuese janë: 231,436.00 euro prej të cilave 218,636 euro janë nga taksa për licencë. Me Marrëveshjen e Memorandum Mirëkuptimit në mes të KPM-së dhe MEF-it, nga të hyrat e gjeneruara nga taksa për licencë, për zhvillimin e aktiviteteve të KPM-së janë ndarë 188,340.00 euro.

Gjatë vitit 2010 janë realizuar katër Projekte Kapitale:

1. Softuer për Menaxhim të Spektrit Frekuencor është realizuar me 249,716.00 euro nga 250,000.00 euro;
2. Monitorimi Statik i Mediave është realizuar me 97,402.00 euro nga 100,000.00 euro;
3. Veturat zyrtare është realizuar me 96,100.00 euro nga 100,000.00 euro dhe
4. Skener, Kopjues për Arkiv Digjital është realizuar me 9,489.00 euro nga 10,000.00 euro.

Buxheti i KPM-së është realizuar për 95%.

Raporti buxhetor i KPM-së do të paraqitet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa.

PJESA V

PREZANTIMI I PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA TË MEDIAVE (BAM)

Bordi për Ankesa të Mediave (“BAM”) është organ i pavarur i themeluar në pajtim më nenin 21 të Ligjit të KPM-së. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me vendimet e Këshillit të KPM-së.

Komisioni i Pavarur për Media gjatë vitit 2010 konkretisht nga data 11 janar 2010 deri me 23 shtator 2010, është ballafaquar me mungesën e Bordit për Ankesa të Mediave, për shkak të mos emërimit të anëtarëve të BAM-it nga ana e Kuvendit të Kosovës. KPM me datën 26 shkurt 2010, ka dorëzuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës 5 nominime për anëtarë të BAM-it. Gjykata Supreme me datën 1 mars 2010, e ka njoftuar KPM-në se procesi i vlerësimit të nominimeve nga ana e Gjykatës Supreme ka përfunduar dhe se Gjykata ka dërguar në Kuvendin e Kosovës propozimin për emërimin e dy kandidatëve nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KPM me datën 12 mars 2010, ka njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se njëri prej kandidatëve të propozuar nga ana e Gjykatës Supreme për anëtar të BAM-it paraqet konflikt interesi

ku Kuvendi i Republikës së Kosovës ka refuzuar emërimin e kandidatit të propozuar nga ana e Gjykatës Supreme.

KPM me datën 9 korrik 2010, ka kërkuar nga Gjykata Supreme që të njoftohet zyrtarisht se cili është vendimi i Gjykatës pas refuzimit të emërimit të kandidatit nga ana e Kuvendit të Kosovës. Gjykata Supreme me datën 12 korrik 2010, ka udhëzuar KPM-në që të përsërisë procesin e nominimeve.

KPM në bazë të propozimit të Gjykatës Supreme nga data 22 korrik deri me datën 6 gusht 2010, ka shpallë ftesën për nominime të reja ku ka pranuar gjithsejtë 4 nominime. KPM më datën 13 gusht 2010, ka dorëzuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës 4 nominime për anëtarë të BAM-it, të cilat nominime Gjykata Supreme i ka përcjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 23 shtator 2010, pas shqyrtimit të propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave, mori vendim që të emërohen anëtarët Bordit për Ankesa të Mediave.

Seancat e BAM-it dhe Vendimet

Bordi për Ankesa të Mediave (“BAM”) gjatë vitit 2010 ka shqyrtuar gjithsej 8 ankesa ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së. BAM-i gjatë vitit 2010 ka mbajtur tri seanca, më 1 e 2 nëntor dhe më 17 dhjetor 2010.

Palët të cilat janë ankuar ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së gjatë vitit 2010:

1. Transmetuesi Publik RTK – Ka paraqitur tri Ankesa ndaj Vendimeve të Këshillit të KPM-së, pranë Bordit për Ankesa të Mediave. BAM është organ i shkallës së dytë dhe vendimet e BAM janë përfundimtare. Pas shqyrtimit të Ankesave të RTK-së, BAM-i ka vërtetuar Vendimet e Këshillit të KPM-së dhe në bazë të Vendimeve përfundimtare, RTK obligohet të paguaj gjobë në vlerë prej 105,000.00 € (njëqind e pesëmijë euro). Mjetet nga gjobat e shqiptuara nga KPM, derdhen në buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës;
2. Operatori Kabllor - Kujtesa – ka paraqitur dy Ankesa ndaj dy Vendimeve të Këshillit të KPM-së, pranë Bordit për Ankesa të Mediave. BAM-i edhe pas dy seancave të mbajtura për rastin e operatorit kabllorë Kujtesa, nuk ka nxjerr vendim përfundimtarë dhe për këtë ka organizuar edhe një seancë e cila duhet të mbahet me datë 24 shkurt 2011.
3. Operatori Kabllor – Tele Net ka paraqitur një Ankesë ndaj Vendimit të Këshillit të KPM-së dhe pas shqyrtimit të kësaj anekese nga ana e BAM-it, operatorit kabllorë Tele-Net i është revokuar licenca për të operuar si operator kabllorë;
4. Subjekti Transmetues – Radio Pandora ka paraqitur një Ankesë ndaj Vendimit të Këshillit të KPM-së dhe pas shqyrtimit të kësaj anekese nga ana e BAM-it, Radio Pandorës përfundimisht ju është revokuar licenca për transmetim; dhe
5. Subjekti Transmetues – Radio Globi ka paraqitur një Ankesë ndaj Vendimit të Këshillit të KPM-së dhe pas shqyrtimit të kësaj anekese nga ana e BAM-it, Radio Globit ju është revokuar licenca për të transmetim.

BAM-i në seancën e muajit nëntor të vitit 2010 ka shqyrtuar dy (2) ankesa të RTK-së kundër Vendimeve të Këshillit të KPM-së për Shkelje të Rregullores KKPM 2009/04, kurse në seancën e muajit dhjetor, ka shqyrtuar edhe ankesën e tretë (3) të këtij subjekti gjithashtu për Shkelje të Rregullores KKPM 2009/04. Në të tri rastet, BAM-i ka vërtetuar vendimet e Këshillit si të ligjshme.

BAM në seancën e nëntorit të vitit 2010, ka shqyrtuar ankesën e Operatorit Kabllor Tele Net. BAM në këtë seancë ka hedhur poshtë ankesën si të pabazë dhe ka vërtetuar Vendimin e Këshillit të KPM-së.

Në seancën e mbajtur në muajin nëntor 2010, BAM ka shqyrtuar ankesat e subjekteve transmetuese Radio Pandora dhe Radio Globi kundër vendimeve të Këshillit. BAM në këtë seancë ka vërtetuar vendimet e Këshillit të KPM-së.

Sqarim për shkurtesat e përdorura

KPM - Komisioni i Pavarur për Media

ITU - Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit

BAM – Bordi për Ankesa të Mediave

DMA - Departamenti i Monitorimit dhe Analizave

DMF – Departamenti i Menaxhimit Frekuencor

DLIC – Departamenti i Licencimit

OK – Operatorët Kabllorë

OSHP – Ofruesit e Shërbimeve Programore

ICO – Zyra Civile në Kosovë

AMPEK – Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës

ART – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit

IREX – Bordi ndërkombëtar për Hulumtime dhe Këmbime

IPA – Instrumenti i ndihmës për para-anëtarësim